

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-23804

Dt.30.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: “**Alsi & Co-Kosocvë**” L.L.C. me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 7136300, e përfaqësuar nga Astrit (Gani) Haxhismajli nga Gjakova sipas Aktit Noterial – Autorizimm ne nr. LRP.nr.2829, dt.22.03.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 17, 18, 19, 20 dhe 21, nenit 25.2 të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Planifikimin dhe Ndërtimin e objekteve në territorin e Komunës së Gjakovës 01 Nr 011-2233 të datës 31.03.2011 si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

## AKTVENDIM

**I. ILEJOHET:** aplikuesit: “**Alsi & Co-Kosocvë**” L.L.C. me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 7136300, e përfaqësuar nga Astrit (Gani) Haxhismajli nga Gjakova sipas Aktit Noterial – Autorizimm ne nr. LRP.nr.2829, dt.22.03.2017ndërtimi – montimi i paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, me kapacitet prej 3MWh, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Komunal, Rregulloren mbi rregullat dhe procedurat për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve në territorin e komunës së Gjakovës, si dhe Vendimin mbi Kushtet Ndërtimore, me numër 07-351/02-17001, të datës 22.11.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrat kadastrale me nr. 68/2, 71/15, dhe 73/2, Z.K. Kodra e Hutit, në pronësi të “**Alsi & Co-Kosocvë**” (Qirambajtje 99 vite), të cilat kanë vijën e ndërtimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike në fjalë, të cilat do të shtrihen me sipërfaqe të përgjithëshme prej 4.46.69 ha.


**II.** Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi – montimi i paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, me kapacitet prej 3MWh, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë “**Alsi & Co-Kosocvë**” L.L.C. me seli në Prishtinë.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijave të ndërtimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**IV.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

**V.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



## Arsyetim

“Alsi & Co-Kosocvë” L.L.C. me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit 7136300, e përfaqësuar nga Astrit (Gani) Haxhismajli nga Gjakova sipas Aktit Noterial – Autorizim nr. LRP.nr.2829, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-23804 të datës 30.11.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – montimin e paneleve solare – impiantit fotovoltaiik për prodhimin e rrymës elektrike, në ngastrat kadastrale me nr. 68/2, 71/15, dhe 73/2, Z.K. Kodra e Hutit, në pronësi të “Alsi & Co-Kosocvë” (Qirambajtje 99 vite), siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:2000 të datës 22.11.2017, të vërtetuar nga DUMM.
2. Kopjen e planit të datës 14.07.2017 në pronësi të “Alsi & Co-Kosocvë” L.L.C. me seli në Prishtinë të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatat mbi të drejtën në pronë e paluajtshme me numër të lëndës 1218/17, të datës 14.07.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin me nr.07-351/02-17001, të datës 22.11.2017, për Kushte Ndërtimore, të lëshuar nga DUMM.
5. Aktin Noterial – Autorizim, me nr LRP.nr.2929/2017, dt.22.03.2017.
6. Deklaratën e përbashkët për shfrytëzimin e përbashkët të hapësirave menaxhuese, të vërtetuar nga Noteri me nr. Akt en Brevet – Nr.rend.3589/2017, dt.03.08.2017.
7. Elaborati – Studimi Gjeomekanik, “Ndërtimi i Parkut Solar” trualli zona kadastrale Kusar, fshati Madanaj – Gjakovë, Ivestitor Alsi & Co”-Kosovë L.L.C. i hartuar nga “Geomerkur” - Gjakovë.
8. Vendimin me nr. 17/2022/1-322/DMM, datë 16.06.2016, mbi aprovimin e kërkesës, për pëlqimi mjedisor lidhur me projektin për ndërtimin e parkut të energjisë diellore në Kusar, nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.
9. Certifikata mbi regjistrimin e Biznesit, me nr.71363600, nga Agjensioni per Regjistrimin e Bizneseve.
10. Pëlqimin nga, me nr.276/17, të datës 29.11.2017, Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Departamenti i Parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit, Ministria e Punëve të Brendshme-RKS.
11. Pëlqimin mbi ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320-01-2385 dt.23.11.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-RKS.
12. Vërtetimin me nr. 04 nr.330101-00729251/17, dt.04.04.2017, nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qendrushem, Komuna e Prishtinës, për mos pasjen e obligimeve mbi pagesën e taksës komunale.
13. Vërtetimin mbi kryerjen obligimeve nga tatimi në pronë, me nr.430/B/815, dt.29.11.2017.
14. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë me nr. 1302 i datës 25.07.2017.
15. Pëlqimin nga K.R.U.”Radoniqi”Sh.A.-Gjakovë, me nr.2194, i datës 21.07.2017.
16. Pëlqimin nga TK-Gjakovë, me nr.34, dt. 18.07.2017.
17. Vërtetimin nga K.R.M.”Çabrati”, nr.649 dt.18.07.2017.
18. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në BKT-Gjakovë, filiala ne Gjakovë me datë 30.11.2017.
19. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, nga “Alsi & Co-Kosocvë” L.L.C. me seli në Prishtinë”.

Taksa administrative është paguar në vlerën prej 11936.20 Euro.

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për Çështje juridike

Zenel Shabani jur.i dipl.

U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.



# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria-Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kodra e hutit

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type            | Sipërfaqja/Povšina/Area m2 |
|----------------------|----------------------------|----------------------------|
| P-70705041-00073-2   | Pracelë / Parcela / Parcel | 17638,0                    |
| P-70705041-00071-15  | Pracelë / Parcela / Parcel | 1713,0                     |
| P-70705041-00069-12  | Pracelë / Parcela / Parcel | 25318,0                    |
|                      |                            |                            |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:5000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.07.2017

Koha/ Vreme/ Time: 11:30:02

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovot/Usvojio/Approved: MCO GJAKOVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: